

Plani Strategjik i Veprimit

2017
19

Plani Strategjik i Veprimit

2017
19

SHQIP

PËRMBAJTJE

MISIONI	04
VIZIONI	04
VLERAT	04
QËLLIMET STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT PËRKATËSE	05
1. SIGURIMI I DIVERSITETIT DHE PLURALIZMIT	05
2. FORCIMI I TRANSPARENCËS DHE LLOGARIDHËNIES	05
3. PROMOVIMI I TRANSMETIMIT TË PËRGJEGJSHËM NË DREJTIM TË PËRMIRËSIMIT TË PËRMBAJTJEVE AUDIO DHE AUDIOVIZIVE	06
4. PËRFORCIMI I QEVERISJES DHE ZHVILLIMI I ORGANIZATËS	06
TABELA E PLANIT STRATEGJIK	08

I. Misioni

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) ka misionin të sigurojë që të gjitha shërbimet audiovizive të përmbushin nevojat e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, duke respektuar kombin, gjuhën, traditën, besimet fetare, kulturën dhe moralin qytetar, në përputhje me vlerat demokratike të përcaktuara në Kushtetutë, veçanërisht sa i përket lirisë së shprehjes dhe medias.

Gjatë ushtrimit të funksioneve të tij AMA i përkushtohet veçanërisht respektimit të të drejtave morale dhe ligjore dhe kërkesave për mbrojtjen e të miturve.

II. Vizioni

Si një autoritet i pavarur rregullator në sektorin audioviziv, AMA është i përkushtuar t'i shërbejë shoqërisë shqiptare përmes rregullimit, mbështetjes dhe nxitjes së tregut audioviziv, në mënyrë që shërbimet audiovizive të pasqyrojnë, sa më mirë të jetë e mundur, vlerat, aspiratat dhe identitetin kombëtar shqiptar. Në rolin e tij si rregullator, AMA nxit mekanizmat që i bëjnë shërbimet audiovizive sa më të aksesueshme të jetë e mundur për popullatën, si nga pikëpamja teknike ashtu edhe ajo teknologjike. Për më tepër, AMA investohet që përmbajtja e ofruar të jetë në përputhje me dispozitat ligjore, për përmbajtje të paanshme në kuadrin e të drejtës për informim, përkatësi fetare dhe politike, personalitet, dinjitet, të drejta dhe liri të tjera themelore të njeriut, duke i mundësuar kështu publikut të krijojë opinionin e vet të lirë.

III. Vlerat

VLERAT BAZË, QË FORMËSOJNË AMA-N DHE INFORMOJNË QASJEN E TIJ NDAJ FUNKSIONIT RREGULLATOR, JANË SI VIJON:

- **Motivuar nga interesi publik** - AMA ekziston për t'i shërbyer nevojave të kombit dhe shoqërisë shqiptare. Interesi publik është thelbësor në të gjithë vendimmarrjen.
- **I drejtë dhe proporcional** - AMA kryen funksionin rregullator në mënyrë efikase, të drejtë dhe proporcionale, të orientuar ndaj qëllimeve të tij statusore. Ai tregon drejtësi dhe baraspeshë gjatë proceseve, procedurave dhe vendimeve të tij, duke zbatuar rregulloret që janë të përshtatshme dhe me synim të qartë.

- **I pavarur dhe i paanshëm** - AMA vlerëson statusin e tij si një organ rregullator i pavarur. Opinionet dhe vendimet e AMA-s janë të pavarura dhe të paanshme dhe të bazuara në shfrytëzimin e informacionit cilësor.
- **Llogaridhënës, transparent dhe efikas në kosto** - AMA vlerëson llogaridhënien, transparencën dhe efikasitetin në kosto. AMA është e angazhuar të përdorë burimet e tij me efikasitet dhe të krijojë vlerë për paratë e shpenzuara, gjatë punës për arritjen e qëllimeve të tij statusore.

IV. Qëllimet strategjike dhe objektivat përkatëse

QËLLIMET STRATEGJIKE TË AMA-S, QË DO TË MBULOJNË PERIUDHËN TREVJEÇARE TË STRATEGJISË, KU ÇDO QËLLIM PËRMBAN OBJEKTIVAT SPECIFIKË, JANË SI MË POSHTË VIJON:

1. **Sigurimi i diversitetit dhe pluralizmit** - Lehtësimi i ofrimit të një game të shumëllojshme përmbajtjeje audiovizive nga shërbimet e transmetimit dhe sigurimin e pluralizmit në transmetim
 - i. AMA do të sigurojë akses për shikuesit dhe dëgjuesit në një gamë të shumëllojshme shërbimesh dhe programesh nga një sërë transmetuesish në të gjitha platformat përkatëse që plotësojnë nevojat e tyre dhe pasqyrojnë diversitetin e tyre.
 - ii. AMA do të inkurajojë dhe mbështesë në mënyrë aktive transmetuesit duke zbatuar skema për mbështetjen e prodhimit të përmbajtjes audio dhe audiovizive me cilësi të lartë që shton diversitetin në programacionin e ofruar tek auditori.
 - iii. AMA do të mbrojë pluralizmin përmes shqyrtimit të vet strategjik të shërbimeve të transmetimit, përmes procedurave të tij për licencimin e OSHMA-ve dhe duke trajtuar me kujdes çështjet e pronësisë dhe kontrollit të kontraktorëve të transmetimit.
2. **Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies** - Mbikqyrja dhe monitorimi i zbatimit nga transmetuesit sipas statutit dhe kontratës

- i. AMA do të mbikqyrë të gjithë transmetuesit e licencuar nga Autoriteti sipas statutit dhe kontratës, duke siguruar që ata të funksionojnë në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës, licencave dhe të gjitha statuteve përkatëse të tyre.
- ii. AMA do të mbikqyrë Transmetuesin e Shërbimit Publik në përputhje me kërkesat ligjore, që ky transmetues të vijojë të ofrojë një nivel shërbimi që pritet prej tij nga publiku.
- iii. AMA do të promovojë dhe monitorojë procesin e ankesave nga shikuesit dhe dëgjuesit si një mjet për lehtësimin e komunikimit midis transmetuesve dhe publikut.

3. Promovimi i transmetimit të përgjegjshëm në drejtim të përmirësimit të përmbajtjeve audio dhe audiovizive - Bashkëpunim me personat dhe organizatat për të përforcuar kapacitetet e tyre për përmbushjen e nevojave të publikut

- i. AMA do të vijojë punën e deritanishme duke identifikuar fushat me përparësi për mbështetje dhe do të angazhohet me persona dhe organizata me qëllim që të përforcojë aftësinë e transmetuesve për të ofruar përmbajtje që përmbush nevojat e shikuesve dhe dëgjuesve.
- ii. AMA do të angazhohet me publikun, transmetuesit dhe palët e tjera të interesit në një sërë mënyrash për t'i mundësuar atyre të jenë të përfshirë dhe të informuar në debatin për rregulloret e transmetimit dhe pritshmëritë e tyre ndaj transmetuesve.

4. Përforcimi i qeverisjes dhe zhvillimi i organizatës - Për të qenë një organizatë e shërbimit publik e zhdërvjellët, efikase, që evoluon vazhdimisht

- i. AMA do të jetë një organizatë e besueshme, efikase dhe llogaridhënëse, që është e angazhuar ndaj standardeve më të larta të qeverisjes institucionale. AMA përdor burimet me efikasitet dhe fleksibilitet dhe do të ruajë këtë qasje.
- ii. AMA do të zhvillohet më tej si një organizatë që mëson. Personeli i motivuar me dëshirë për të mësuar do të vazhdojë të angazhohet e t'i përgjigjet ndryshimit dhe të reagojë në lidhje me pasojat e tij.
- iii. AMA do të vazhdojë të reduktojë barrën burokratike për veten duke identifikuar mënyra më efikase, për të arritur qëllimet e tij. AMA do të zgjerojë përdorimin e teknologjisë së informacionit për të rritur efikasitetin dhe aksesueshmërinë në publik.

Tabela e Planit Strategjik



FUSHA E VEPRIMIT	VEPRIMTARITE ME PERPARESI	REZULTATI I PRITSHEM	AFATI			QELIMI STRATEGJIK
			2017	2018	2019	
Kalimi ne transmetimet numerike						
Ndjekja e zbatimit te akteve finale te miratuara ne Regional Radiocommunication Conference 06. Lirimi I Digital Divident 1	Ndjekja e procesit te liritimit te frekuencave te digjital dividetit si rrjedhoje e licencimeve te operatoreve private per transmetime numerike tokesore.	Marrjen e masave per shmangjen e çdo interference te demshme shkaktuar ne vendet fqinj ne kuader te zbatimit te plote te Marreveshjes se Ge-06	X			Sigurimi i diversitetit dhe pluralizmit
Migrimi i frekuencave per cdo allotment ne kalimin nga transmetimet analoge ne ato numerike	Percaktimi I grafikut te migrimit te frekuencave te perdorura aktualisht nga transmetimet analoge ne rrjetet numerike te licencuara nga AMA.	Garantimi i mosnderprerjes se transmetimeve audiovizive si rrjedhoje e migrimit te frekuencave nga transmetimet analoge ne ato numerike.	X	X	X	Sigurimi i diversitetit dhe pluralizmit
Kuadri ligjor Aktet nenligjore dhe Politikat						
-	Rregullore per "Procedurat dhe kriteret per leshimin e licencave lokale te transmetimit gjate periudhes tranzitore"	Rregullorja synon te percaktoje procedurat dhe kriteret per licencimin e orfuesve lokale dhe rajonale gjate periudhes tranzitore te kalimit nga teknologjia e transmetimeve analoge ne ate digjitale	X			Sigurimi i diversitetit dhe pluralizmit
-	Rregullore per "Ofrimin e sherbimeve te kushtezuara te aksesit dhe sherbimeve te tjera perkatese te mbeshtetjes"	Rregullorja synon te percaktoje rregullat qe sigurojne qe te gjitha sherbimet e kushtezuara te ofrohen bazuar ne te njejat terma te arsyeshem dhe jo diskriminues. Ofruesit e sherbimeve te kushtezuara kane detyrimin te ofrojne akses ne nderfaqet / programet e aplikimit te pershtatesve, ose udhezimet e programeve elektronike sipas termave te drejta, jo diskriminuese dhe te pershtatshme.		X		Sigurimi i diversitetit dhe pluralizmit
-	Rregullorja per "Regjistrimin e transmetimit"	Rregullorja synon te percaktoje rregullat qe duhet te ndiqen nga te gjithe operatoret per regjistrimin e transmetimeve te tyre dhe termat e ruajtjes.		X		Forcimi i Transparences dhe Llogaridhenies



FUSHA E VEPRIMIT	VEPRIMTARITE ME PERPARESI	REZULTATI I PRITSHEM	AFATI			QELIMI STRATEGJIK
			2017	2018	2019	
Kuadri ligjor Aktet nenligjore dhe Politikat						
-	Rregullorja per "Monitorimin e frekuencave"	Kjo rregullore synon te percaktoje procedurat per monitorimin e spektrit te caktuar per ofruesit e sherbimeve te televizioneve tokesore dhe audio.	X			Forcimi i Transparences dhe Llogaridhenies
-	Rregullore per "Kriteret dhe masat qe rregullojne bashke-perdorimin e infrastruktures transmetuese te Transmetuesit Publik"	Kjo rregullore percakton rregullat dhe procedurat per bashke-perdorimin e infrastruktures transmetuese te RTSH nga ofruesit e sherbimeve te medias audio dhe/ose audiovizive te licencuar per transmetime tokesore audio dhe / ose audiovizive			X	Sigurimi i diversitetit dhe pluralizmit
-	Rregullore per "Reklamat dhe komunikimet tregtare audio dhe/ose audiovizive. Format, kushtet dhe koha ditore e lejuar per transmetimin e reklamave".	Kjo rregullore synon te percaktoje formatin e komunikimeve audio dhe/ose audiovizive te natyres tregtare, kushtet dhe kohen ditore te lejuar per transmetimin e tyre bazuar ne ligj	X			Sigurimi i diversitetit dhe pluralizmit
-	Rregullore per "Dhenien e licencave te transmetimit per periudhe te perkohshme dhe per nevoja institucionale"	Rregulloret synojne te percaktojne kriteret dhe procedurat per dhenien e licencave te transmetimeve audio per periudha te perkohshme institucionale publike per nevoja te percaktuara			X	Sigurimi i diversitetit dhe pluralizmit
-	Rregullore per "Promovimin e prodhimeve evropiane nga sherbimet e mediave audio dhe/ose audiovizive bazuar ne kerkesen e perdoruesit	Rregullorja synon te percaktoje rregullat dhe kriteret qe duhet te ndiqen nga operatoret mediatike per te promovuar me mire prodhimet evropiane, sipas kerkesave te Ligjit Nr. 97/2013			X	Promovimi i Transmetimit te Pergjegjshem



FUSHA E VEPRIMIT	VEPRIMTARITE ME PERPARES	REZULTATI I PRITSHEM	AFATI			QELLIMI STRATEGJIK
			2017	2018	2019	
Kuadri ligjor Aktet nenligjore dhe Politikat						
-	Rregullore per "Percaktimin e ngjarjeve te interesit publik, menyren e transmetimit te tyre dhe te drejten per raportime te shkurtra si lajme"	Rregullorja synon te percaktoje rregullat, kriteret dhe procedurat per transmetimin e lajmeve te shkurtra mbi ngjarje me rendesi madhore per publikun, si dhe kohezgjatjen e ketyre transmetimeve sipas Ligjit 97/2013		X		Promovimi i Transmetimit te Pergjegjshem
-	Udherrefyese per zgjidhjen e konfliktit midis operatoreve te medias audio dhe/ose audiovizive, perfshire mosmarreshjet me transmetuesin publik	Udherrefyese synon te percaktoje procedurat qe do te perdoren nga AMA ne rast mosmarreshjeje midis operatoreve private dhe/ose transmetuesit publik ne lidhje me veprimtarite e tyre.			X	Forcimi i Transparences dhe Llogaridhenies
Infrastruktura e informacionit dhe njohurive						
Administrim i te dhenave dhe dokumentacionit te OSHMA-ve	Azhornimi i regjistrit te licencave/autorizimeve duke pasqyruar cdo te dhene per OSHMA-te	Regjistër për OSHMA sipas kërkesës	X	X	X	Forcimi i Qeverisjes dhe Zhvillimi Organizativ
Buletini Periodik të AMA-s, mbi informacionin për sektorin e mediave audiovizive	Tregues nga dinamika e tregut audioviziv në Shqipëri përmbajtja e programeve, teknika, ekonomike financiare, burimet njerezore etj.	Publikimi i një database që t'i vlejë grupeve të interesit, kërkuësve dhe studiuesve të tregut audioviziv, institucioneve, qytetarëve etj.	X	X	X	Promovimi i Transmetimit te Pergjegjshem
Ri-vleresim i autonomise financiare te AMA-s duke e perqendruar kryesisht ne permiresimin e struktures se tij te tarifimit, mbledhjen e tarifave dhe strategjine e zbatimit.	Percaktimi i një strukture me indikatorët e aksesueshëm nga pasqyrat financiare që subjektet depozitojnë në AMA; Gjenerimin e një raporti sasior (%) të realizimit të këtyre indikatorëve sipas llojit të shërbimit, ndarjes administrative të subjekteve dhe mbulimit territorial	Sipas % të rezultuara të realizimit të indikatorëve mund të bëhet një analizë më e saktë për percaktimin e pagesave që subjektet duhet të paguajnë në AMA	X			Sigurimi i diversitetit dhe pluralizmit

FUSHA E VEPRIMIT	VEPRIMTARITE ME PERPARES	REZULTATI I PRITSHEM	AFATI			QELIMI STRATEGJIK
			2017	2018	2019	
Infrastruktura e informacionit dhe njohurive						
Hartimi i nje plani per kryerjen e studimit mbi matjen e Audiences Televizive	Hulumtimi i mundesive per monitorim dhe pluralizem efikas te tregut mediatik	Fillimi dhe kryerja e punes kerkimore me auditorin; perdorimi dhe aplikimi i te dhenave te perftuara nga puna kerkimore	X			Promovimi i Transmetimit te Pergjegjshem
Administrimi sistemeve te brendshme te menaxhimit te informacionit dhe administrimi i rrjetit kompjuterik. Administrimi procesve ne lidhje me sigurine fizike dhe informacionin e te dhenave TIK	(Krijimi dhe implementimi i procedurave ne lidhje me Administrimin, Monitorimin e sistemeve dhe proceseve TIK)*	Permiresimi dhe standartizimi i procesve ditore/mujore/vjetore si dhe krijimi rregullave qe do te optimizojne kohet ne implementim dhe mirembajtje te sistemeve dhe proceve TIK	X	X	X	Forcimi i Qeverisjes dhe Zhvillimi Organizativ
Veprimtarite e Mbikeqyrjes dhe Perputhshmerise						
Perafrimi i metodologjive dhe procedurave per monitorimin e mbulimit me sinjal me standardet e monitorimit te shfrytzezimit te spektrit te frekuencave ne terren	Hartimi i rregulloreve dhe procedurave te monitorimit te perdorimit te spektrit te frekuencave dhe mbulimit me sinjal ne perputhje me standardet dhe praktiket me te mira ne kete fushe. Pajisja me mjetet elektronike matese ne perputhje me keto standarde.	Rritja e efikasitetit mbikqyres se zbatimit e kushteve teknike te transmetimit nga operatoret.	X	X		Forcimi i Transparences dhe Llogaridhenies
Garantimi i te drejtes se shtetasve per te marrë shërbime cilësore të transmetimeve audio dhe/ose audiovizive.	Kontroll i cilësisë së marrjes së sinjaleve në zonat e mbulimit Kërkim i zgjidhjeve për ankesat e publikut për cilësinë e transmetimit të sinjaleve audiovizive.	Përmirësimi i marrëdhënies mes ofruesve të shërbimeve (subjekteve OSHMA) dhe marrësve të këtyre shërbimeve (abonentëve/ shtetasve), në kuadër të respektimit të përcaktimeve ligjore.		X	X	Forcimi i Transparences dhe Llogaridhenies
Mbikeqyrja e tërësisë së programeve të transmetuara nga subjektet OSHMA.	Inspektimi dhe vlerësimi i veprimtarive audio dhe/ose audiovizive;	Ulja e piraterisë. Respektim i të drejtave të transmetimit dhe të drejtave të autorit.	X	X	X	Forcimi i Transparences dhe Llogaridhenies



FUSHA E VEPRIMIT	VEPRIMTARITE ME PERPARES	REZULTATI I PRITSHEM	AFATI			QELIMI STRATEGJIK
			2017	2018	2019	
Veprimtarite e Mbikeqyrjes dhe Perputhshmerise						
Hartimi i Axhendes Rregullatore per RTSH	Zbatimi i politikës në raportet AMA-RTSH, në përputhje me detyrimet e Kontratës së Shërbimit Publik, veçanërisht në ndërtimin programor të platformës digjitale tokësore të këtij institucioni.	-siguria që Transmetuesi Publik zbaton Kontratën e Shërbimit Publik dhe Deklaratën e Qëllimit- llojshmëri, cilësi programesh	X	X	X	Forcimi i Transparencës dhe Llogaridhënie
Monitorimi dhe Arshiva	Krijimi i nje strategjie monitorimi te plote, proporcionale dhe afat gjate. Parimet udherrefyese te kesaj strategjie duhet te jene ekuilibri territorial, trajtimi i barabarte dhe kriteret e perparesite e monitorimit te arsyeshme, proporcionale dhe te justifikuar siç duhet.	Kultura e Arshivimit te Transmetimeve mbeshtetet permes zbatimit te frytshem te Skemes se Arshivimit	X	X	X	Forcimi i Transparencës dhe Llogaridhënie
Transmetimi						
Rregullimi i spektrit frekuencor ne brezin Audio FM	* Vleresimi i perputhshmerise se pikave transmetuese dhe frekuencave te licencuara per transmetimet audio në Republiken e Shqipërisë me marreveshjet nderkombetare ne fuqi.	Regulated broadcasting marked	X	X		Ensuring diversity & plurality
Shtimi i kapaciteteve transmetuese te planit Shqiptar te frekuencave ne brezin UHF/VHF te percaktuara ne marreveshjen e GE06.	Koordinimi me vendet nenshkruese te Marreveshjes se GE06 mbi riorganizimin e frekuencave te planeve frekuencore perkatese per evidentimin e hapësirave te optimizimit dhe te shtimit te kapaciteteve transmetuese.	Shtimi i numrit te rrjeteve numerike audiovizive kombetare, rajonale e lokale.	X			Ensuring diversity & plurality
Veprimtarite e Licencimit						
Licensimi	Plan studimi lidhur me numrin, fusheveprimin dhe natyren e autorizimeve/licencave te propozuara per t'u leshuar gjate afatit te strategjise, duke marre ne konsiderate sigurimin e pluralizmit dhe diversitetit te sektorit shqiptar te transmetimit dhe gjithashtu duke siguruar nje zhvillim te pergjegjshem te tij qe permbush te gjitha nevojat e qytetareve.	Rregullimi i tregut te transmetimeve	X			Sigurimi i diversitetit dhe pluralizmit



FUSHA E VEPRIMIT	VEPRIMTARITE ME PERPARES	REZULTATI I PRITSHEM	AFATI			QELIMI STRATEGJIK
			2017	2018	2019	
Veprimtarite e Licencimit						
-	Perfundimi I licencimit te sherbimeve radio te komunitetit sipas udhezimeve te Autoritetit	-	X			Sigurimi i diversitetit dhe pluralizmit
-	Zbatimi I Planit te Licencimit per Sherbimet e Transmetimit	-	X	X		Sigurimi i diversitetit
Proceset e reja te licencimit	Studimi dhe vleresimi i ndikimit te procesit te kalimit ne transmetime digjitale ne tregjet lokale.	Rregullimi i tregut te transmetimeve	X			Sigurimi i diversitetit dhe pluralizmit
Teknologjite e reja	Plan veprimi 3 vjeçar qe merr ne konsiderate pranine e aktoreve te rinj (IPTV, transmetues permes internetit dhe OTT) dhe vleresimi i autorizimeve te reja qe do te leshohen ne kete fushe dhe menytrat me te mira per monitorimin e veprimtarive te ketyre operatoreve.	-	X	X		Sigurimi i diversitetit dhe pluralizmit
Parandalimi i shfrytezimit te jashteligjshem te frekuencave	Hartimi i nje procedure dhe protokolli monitorimi per te mundesuar trajtimin e pershtatshem dhe ne kohe te ketyre çeshtjeve.	-		X		Forcimi i Transparences dhe Llogaridhenies
Promovimi i transmetimit te pergjegjshem dhe fuqizimi i auditorit						
Performanca e Transmetuesit Publik dhe e OSHMA te tjera	Nje studim tregu qe percakton se çfare mund te presin shikuesit dhe degjuesit nga transmetuesit, veçanerisht nga transmetuesi publik, ne menyre qe ata te jene ne dijeni te nevojave ne zhvillim te auditorit dhe qe te pershtatin sherbimet e tyre per te permbushur keto nevoja.	-ndërgjegjësim i OSHMA-ve për respektimin e ligjit 97/2013 dhe Kodin e Transmetimit		X		Promovimi i Transmetimit te Pergjegjshem



FUSHA E VEPRIMIT	VEPRIMTARITE ME PERPARES	REZULTATI I PRITSHEM	AFATI			QELIMI STRATEGJIK
			2017	2018	2019	
Promovimi i transmetimit te pergjegjshem dhe fuqizimi i auditorit						
Shqyrtimi, dhe rishikimi i Kodit te Transmetimit.	Keshillimi per shqyrtimin e Kodit te Transmetimit.	Ndërhyrje në Kodin e Transmetimit të AMA-s për të reflektuar aspekte në favor të sigurimit të një informimi objektiv dhe të paanshëm të publikut, duke paraqitur në mënyrë të saktë faktet dhe ngjarjet, si dhe duke respektuar formimin e lirë të opinionit;	X		X	Promovimi i Transmetimit te Pergjegjshem
Funksionim efikas dhe i frytshem i procesit te ankesave dhe Skemes per te Drejten e Marrjes Pergjigje	Hartimi i nje kodi per rregullat e brendshme te Keshillit te Ankesave	Procesi i ankesave dhe Skema e te Drejtes per te Marre Pergjigje funksionojne ne perputhje me procesin e percaktuar.	X	X	X	Promovimi i Transmetimit te Pergjegjshem
Strategjia e komunikimit me publikun	Keshilli I Ankesave miraton strategjine e vet te komunikimit, imazhit dhe kontaktit me publikun, ne menyre qe rrisi kanalet e komunikimit me publikun	-	X			Promovimi i Transmetimit te Pergjegjshem
Veprimtaria e Autoritetit						
Funksionimi i Autoritetit. Shqyrtohet funksionimi dhe veprimtaria e Autoritetit.	Hartohet dhe zbatohet plani vjetor dhe rekomandimet qe rrjedhin integrohen ne Planin e ri te Zbatimit	Zbatimi i infrastruktures/proceseve te reja sipas planit te hartuar.		X	X	Forcimi i Qeverisjes dhe Zhvillimi Organizativ
Komunikimi dhe Zhvillimi Sektorial						
Politikat e Komunikimit	Miratimi i Strategjisë së Komunikimit Hartimi i Raporteve te AMA-s, periodikëve si Revistë, do të jenë të vlefshme për publikim.	AMA do të behet një zë i besuar në fushën e medias dhe per publiku	X	X	X	Zhvillimi Organizativ



FUSHA E VEPRIMIT	VEPRIMTARITE ME PERPARES	REZULTATI I PRITSHEM	AFATI			QELIMI STRATEGJIK
			2017	2018	2019	
Komunikimi dhe Zhvillimi Sektorial						
Bashkëpunimi Ndërinstitucional	Hartimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me Zyrën e të Drejtave të Autorit, Hartimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me organet ligjzbatuese lidhur me hetimin financiar (Polici e Shtetit; Prokurori; Drejtoria e Pastrimit të Parave)	-	X	X		Promovimi i Transmetimit te Pergjegjshem dhe Fuqizimi i Auditorit
Intensifikimi i bashkëpunimit me partnerët mediatike, për projekte mbi studimin e tregut a zhvillimin e veprimtarisë trajnuese me gazetarët e redaktorët në favor të përmirësimit të performancës në respekt të Kodit të Transmetimit.	Tryeza pune me transmetuesit pas futjes se rregullavedhe/ose procedurave te reja ose te rishikuara sipas rastit, studime tregu, konferenca shkencore, forume diskutime me grupe interesi	Veprimtarite e komunikimit do te ndergjegjesojne publikun, do te mbeshtesin veprimtarite e keshillimit	X	X	X	Promovimi i Transmetimit te Pergjegjshem dhe Fuqizimi i Auditorit
Financat dhe Qeverisja						
Menaxhimi dhe raportimi financiar	Rishikimet e nevojshme të projekt - buxhetit sipas realizimeve faktike të konstatuara gjatë vitit lidhur me disa tregues të të ardhurave dhe shpenzimeve, ku të sigurohet vazhdimësia e aktivitetit të AMA-s pa cënuar respektimin e dispozitave ligjore në fuqi	Rritjen e shkallës së shfrytëzimit me efektivitet të burimeve të financimit dhe manaxhimin e tyre si dhe shmangien e tejkallimeve të pajustificuara të zërave të buxhetit	X	X	X	Forcimi i Qeverisjes dhe Zhvillimi Organizativ
Ruajtjen e aktiveve financiare si dhe sigurimin e ambjenteve të përshtatshme të punës për administratën në respektimi të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.	Hartimi i një udhëzimi të brendshëm lidhur me ruajtjen e aktiveve në përdorim nga punonjësit e administratës, ku të përcaktohen detyrimet mbi raportimin zyrtar lidhur me rastet e konstatimit të dëmtimit, kalimit të përdorim të objektit nga një nëpunës tjetër, apo mbi shfaqjen e nevojës për zëvendësimin e aktivitetit për sa konsumuar ose dëmtuar për shkaqe të ndryshme;	Rritja e shkallës së sigurimit të kapitalit financiar të Institucionit, përmirësimi i kushteve të punës dhe sigurimi i një ambjenti të përshtatshëm	X			Forcimi i Qeverisjes dhe Zhvillimi Organizativ
Zhvillimi i Burimeve Njerëzore dhe Organizative						
Zhvillimi i Burimeve Njerëzore dhe Organizative	Zhvillimi i Burimeve Njerëzore nëpërmjet implementimit të Manualit të Politikave të Burimeve Njerëzore	AMA siguron burime të përshtatshme dhe efektive njerëzore për objektivat e saj.	X	X	X	Forcimi i Qeverisjes dhe Zhvillimi Organizativ

FUSHA E VEPRIMIT	VEPRIMTARITE ME PERPARES	REZULTATI I PRITSHEM	AFATI			QELLIMI STRATEGJIK
			2017	2018	2019	
Zhvillimi i Burimeve Njerëzore dhe Organizative						
Zhvillimi organizativ	Menaxhimi efikas i performances sjell angazhim me te larte te personelit dhe perdorim te pershtatshem dhe zhvillim te aftesive dhe kompetencave te disponueshme per organizaten.	Zbatohen politika dhe strategji BNj, qe i mundesojne AMA-s te permbushe detyrimet e saj statutore dhe qe lehtesojne nje mjedis pune mbeshtetesh per personelin e AMA-s	X	X	X	Forcimi i Qeverisjes dhe Zhvillimi Organizativ
Hartimi i rregullave dhe udhezimeve te brendshme procedurale dhe te funksionimit baze.	Vendosen rregulla te reja dhe gjithepershires te brendshme.	Krijohen dhe shqyrtohen strukturat	X	X	X	Forcimi i Qeverisjes dhe Zhvillimi Organizativ

Adresa: Rruga "Papa Gjon Pali II",
Nr. 15, Kutia Postare 1010, Tiranë
Tel: +355 4 222 6288
Cel: +355 66 20 44 909
e-mail: info@ama.gov.al
www.ama.gov.al